

Në bazë të nenit 56 dhe 57 të Ligjit për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e R. së Maqedonisë, numër 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10 dhe 17/11) dhe Nenet 29-32 të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Bordi i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 07.06.2011, miratoi këtë

## **RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE UDHËHEQJEN E PUNËS SË KËSHILLIT TË REKTORIT**

### *Neni 1*

Me këtë Rregullore përcaktohet përbërja, mënyra e drejtimit dhe veprimit të Këshillit të rektorit, konvokimi i mbledhjes, kryesimi dhe vendosja, zbatimi i vendimeve dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me punën e Këshillit.

### **Përbërja**

#### *Neni 2*

Anëtarë të Këshillit janë:

- Rektori, prorektorët dhe sekretari i përgjithshëm;
- Dekanët e fakulteteve, drejtorët e Institutit të mjedisit dhe shëndetit, Qendrës së gjuhëve dhe Qendrës për e-Learning;
- Presidenti i Parlamentit të studentëve (anëtar pa të drejtë vote)

Sipas nevojës, në punën e Këshillit të rektorit, mund të marrin pjesë dhe drejtorë të njësive tjera akademike ose administrative.

### **Mbledhjet**

#### *Neni 3*

Mbledhjet e Këshillit të rektorit mbahen një herë në muaj. Konvokohen me njoftim nëpërmjet postës elektronike zyrtare: "e-mail"-it. Në raste të veçanta kryesuesi ka të drejtë të caktojë mbledhje të jashtëzakonshme. Njoftimi përfshin datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes si dhe materialet sipas rendit të ditës të propozuar, i cili duhet të dërgohet së paku tri ditë pune para mbledhjes.

Mbledhjet e Këshillit i përgatit dhe udhëheq rektori ose personi i autorizuar nga ai. Personi i autorizuar duhet të jetë anëtar i Këshillit.

Rektori ose personi i autorizuar nga ai, është i obliguar që gjatë udhëheqjes së mbledhjeve t'u përmbahet dispozitave të Statutit dhe kësaj Rregulloreje. Rendi i ditës aprovohet në mbledhjen e Këshillit, me shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm.

### **Mbajtja e rendit në mbledhje**

#### *Neni 4*

Për mbajtjen e rendit në mbledhje, kujdeset kryesuesi i mbledhjes.

Kryesuesi dhe pjesëmarrësit në mbledhjen e Këshillit janë të obliguar t'i përmbahen kësaj Rregulloreje. Stafi duhet të sillet profesionalisht dhe me respekt gjatë tërë kohës kurse kryesuesi duhet të kontrollojë sjelljen e papranueshme.

Mbledhja e caktuar e Këshillit mund të shtyhet ose të ndërpritet në këto raste:

- nëse nuk ka kuorum;
- nëse mbledhja e nisur për shkak të zgjatjes nuk mund të kryhet gjatë asaj dite;
- nëse gjatë mbledhjes bëhen çrregullime të rendit; ose
- kryesuesi nuk është në gjendje ta kryesojë mbledhjen.

Mbledhjen e ndërpret apo e shtyn kryesuesi i mbledhjes

#### **Vendimmarrja**

##### *Neni 5*

Këshilli mund të marrë vendim formal vetëm nëse ka kuorum (kuorum ka vetëm nëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma nga numri i përgjithshëm i anëtarëve). Këshilli i aprovon vendimet me shumicën e votave nga anëtarët prezent.

Kohëzgjatja e diskutimit për çdo pikë të rendit të ditës zgjat deri sa të arrihet zgjidhje në suaza të kornizës kohore të përkrahur nga kryesuesi për të siguruar pjesëmarrje maksimale dhe përdorim eficient të kohës.

#### **Procesverbali nga mbledhja e Këshillit**

##### *Neni 6*

Në çdo mbledhje të Këshillit mbahet procesverbali nga shërbimi profesional i universitetit.

Procesverbali mbahet:

- në dorëshkrim, dhe
- duke incizuar në formë elektronike,

Në procesverbal shënohen të dhënat thelbësore mbi punën e mbledhjes dhe sidomos:

- numri, data dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes;
- emrat e të pranishmëve në mbledhje;
- emrat e atyre që mungojnë në mbledhje;
- rendi i ditës;
- diskutimet specifike që kanë peshë të veçantë për ndonjë çështje relevante;

- vendimet, veprimet dhe afatet kohore.

Procesverbali nënshkruhet nga kryesuesi i Këshillit pasi të miratohet nga Këshilli..

Procesverbali i dërgohet anëtarëve të Këshillit të rektorit kurse nje përmbledhje i qarkullohet stafit të universitetit.

Procesverbali dhe vendimet e Këshillit ruhen nën mbikëqyrjen e rektorit dhe arkivohen sipas Rregullores për punën e arkivit të universitetit.

### **Dispozitat përfundimtare**

*Neni 7*

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga 01.09.2011.